

**KOMISIONI EVROPIAN
KUNDËR RACIZMIT DHE INTOLERANCËS**

**REKOMANDIM N° 3 PËR POLITIKËN E
PËRGJITHSHME I ECRI-T:**

**LUFTIMI I RACIZMIT DHE INTOLERANCËS
KUNDËR ROMËVE/CIGANËVE**

MIRATUAR MË 6 MARS 1998

Strasbourg, 1998



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Secretariat of ECRI
Directorate General of Human Rights and Legal Affairs
Council of Europe
F - 67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: +33 (0) 3 88 41 29 64
Fax: +33 (0) 3 88 41 39 87
E-mail: combat.racism@coe.int

Vizitoni ueb-saitin tonë: www.coe.int/ecri

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës:

Duke kujtuar vendimin e miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në Takimin e tyre të parë të Nivelit të Lartë mbajtur në Vienë më 8-9 tetor 1993;

Duke kujtuar që Plani i Veprimit mbi luftimin e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës i parashtruar si pjesë e kësaj Deklarate ftonte Komitetin e Ministrave që të krijonte Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës me një mandat, ndër të tjera, që të formulonte rekomandime për politikën e përgjithshme për Shtetet anëtare:

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën Përfundimtare të miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në Takimin e tyre të dytë të Nivelit të Lartë mbajtur në Strasburg më 10-11 tetor 1997;

Duke theksuar që kjo Deklaratë Përfundimtare konfirmon që qëllimi i Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës është të ndërtojnë një shoqëri evropiane më të lirë, më tolerante dhe më të drejtë dhe që ai bën thirrje për intensifikimin e luftës kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke vënë re propozimin lidhur me emërimin e një mediatori evropian për Romët/Ciganët të përmbajtur në Rekomandimin N° 1203 (1993) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës;

Duke mbajtur parasysh përfundimet e seminarit për dimensionin njerëzor mbi Romët në zonën e KSBE-së (OSBE-së) të organizuar më 20-23 shtator 1994 nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), në këshillim të ngushtë me Këshillin e Evropës dhe bashkëpunimin e vazhduar ndërmjet dy organizatave në këtë fushë;

Duke mirëpritur emërimin nga Sekretari i Përgjithshëm më 1994 të një Koordinatorit të Veprimtarive të Këshillit të Evropës mbi Romët/Ciganët;

Duke patur parasysh punën e Grupit të Specialistëve mbi Romët/Ciganët (MG-S-ROM);

Duke kujtuar Rekomandimin N° R (97) 21 të Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi median dhe promovimin e një klime tolerance;

Duke kujtuar dispozitat e përmbajtura në rekomandimin N° 1 të ECRIT-t për politikën e përgjithshme, i cili kërkonte të ndihmonte Shtetet anëtare në luftimin efektiv të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës, duke propozuar masa konkrete dhe specifike më një numër të kufizuar fushash veçanërisht përkatëse;

Thellësisht të bindur se Evropa është një komunitet vlerash të përbashkëta, duke përfshirë atë të dinjitetit të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore, dhe që respekti për këtë dinjitet të barabartë është guri i themelit për të gjitha shoqëritë demokratike;

Duke kujtuar që trashëgimia e historisë Evropiane është një detyrë për të kujtuar të kaluarën duke mbetur vigjilentë dhe duke kundërshtuar aktivisht çdo manifestim racizmi, ksenofobie, antisemitizmi dhe intolerance;

Duke nderuar kujtimin e të gjitha viktimave të politikave të persekutimit dhe shfarosjes raciste gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe duke kujtuar që një numër i konsiderueshëm Romësh/Ciganësh u eliminuan si rezultat i politikave të tilla;

Duke theksuar në këtë drejtim se Këshilli i Evropës është mishërimi dhe ruajtësi i vlerave themeluese - në veçanti i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut - rreth të cilave u ndërtua Evropa pas tmerreve të Luftës së Dytë Botërore;

Duke kujtuar që luftimi i racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës përbën një pjesë tërësore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, që këto të drejta janë universale dhe të pandashme, dhe që të gjitha qeniet njerëzore, pa asnjë lloj dallimi, kanë të drejtë për këto të drejta;

Duke theksuar që luftimi i racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës është mbi të gjitha një çështje e mbrojtjes së anëtarëve vulnerabël të shoqërisë;

Të bindur që në çdo veprim për të luftuar racizmin dhe diskriminimin, theksi duhet vënë te viktimat dhe përmirësimi i situatës së tij/saj;

Duke vënë re që Romët/Ciganët vuajnë kudo në Evropë nga paragjykimet persistuese, janë viktimat e racizmit i cili është i rrënjosur thellë në shoqëri, janë shënjestër e disa herë demonstrimeve të dhunshme të racizmit dhe intolerancës dhe se të drejtat e tyre themelore shkelen ose kërcënohen rregullisht;

Duke vënë re gjithashtu se paragjykimet persistuese kundër Romëve/Ciganëve çojnë në diskriminim kundër tyre në shumë fusha të jetës ekonomike dhe shoqërore dhe se ky diskriminim është një faktor madhor në procesin e përjashtimit shoqëror që prek shumë Romë/Ciganë;

Të bindur se promovimi i parimit të tolerancës është një garanci për ruajtjen e shoqërive të hapura dhe pluraliste duke lejuar një bashkekzistencë paqësore;

u rekomandon Qeverive të Shteteve anëtare sa më poshtë:

- të nënshkruajnë dhe ratifikojnë instrumentet përkatëse ndërkombëtare në fushën e luftimit të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës, veçanërisht të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave;
- të sigurojnë që emri i përdorur zyrtarisht për komunitetet e Romëve/Ciganëve duhet të jetë emri me të cilin dëshiron të njihet vetë komuniteti në fjalë;
- duke mbajtur parasysh manifestimet e racizmit dhe intolerancës, viktimat të të cilave janë Romët/Ciganët, t'u japin përparësi të madhe përmbushjes efektive të dispozitave të përmbajtura në rekomandimin N° 1 të ECRI-t për politikën e përgjithshme, i cili kërkon që duhet të merren masat e nevojshme të sigurohet që e drejta kombëtare penale, civile dhe administrative të kundërshtojë racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën shprehimisht dhe dhe në mënyrë specifike;
- të sigurojnë që diskriminimi si i tillë, si edhe praktikat diskriminuese, të luftohen nëpërmjet legjislacionit të përshtatshëm dhe të fusin në të drejtën civile dispozita për këtë qëllim, veçanërisht në fushën e punësimit, strehimit dhe arsimit;
- të bëjnë të jashtëligjshëm çdo diskriminim nga ana e autoriteteve publike në ushtrimin e detyrave të tyre;
- të sigurojnë që t'u jepet ndihmë ligjore e përshtatshme Romëve/Ciganëve, të cilët kanë qenë viktimat e diskriminimit dhe të cilët dëshirojnë të fillojnë proces gjyqësor;
- të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që drejtësia të zbatohet plotësisht dhe në një kohë sa më të shkurtër në çështjet lidhur me shkeljen e të drejtave themelore të Romëve/Ciganëve;
- të sigurojnë veçanërisht që nuk tolerohet asnjë shkallë shpëtimi nga dënimi lidhur me krimet e kryera kundër Romëve/Ciganëve dhe ta bëjnë këtë të njohur për publikun e gjerë;
- të përgatisin dhe mbështesin skema specifike trainimi për personat e përfshirë në të gjitha nivelet e përbërësve të ndryshëm të administrimit të drejtësisë, me synimin që të promovohet mirëkuptimi kulturor dhe një ndërgjegjësim për paragjykimet;
- të inkurajojnë zhvillimin e rregullimeve të përshtatshme për dialog ndërmjet policisë, autoritetetve lokale dhe komuniteteve të Romëve/Ciganëve;
- të inkurajojnë ngritjen e ndërgjegjësimit ndër profesionistët e mediave, si në fushën audiovizuale dhe në shtypin e shkruar, për përgjegjësinë e veçantë që ata mbajnë për të mos transmetuar paragjykimet kur praktikojnë profesionin e tyre dhe në veçanti të evitojnë raportimin e incidenteve që u ndodhin komunitetit të Romëve/Ciganëve në një mënyrë që fajëson komunitetin Rom/Cigan në tërësi;

- të marrin hapat e nevojshme për të siguruar që rregullat lidhur me çështjen e aksesit në shtetësi si de facto edhe de jure dhe e drejta për azil të hartohen dhe të zbatohen që të mos çojnë në diskriminim të veçantë ndaj Romëve/Ciganëve;
- të sigurojnë që çështjet lidhur me “udhëtimin” brenda një vendi, veçanërisht rregulloret lidhur me vendqëndrimin dhe urbanistikën, të zgjidhen në një mënyrë e cila nuk pengon mënyrën e jetesës të personave në fjalë;
- të zhvillojnë rregullime institucionale për të promovuar rolin aktiv dhe pjesëmarrjen e komuniteteve Rome/Cigane në procesin vendimmarrës, nëpërmjet mekanizmave këshillimorë kombëtarë, rajonalë dhe lokalë, duke i dhënë përparësi idesë së partneritetit me bazë barazie;
- të marrin masa specifike për të inkurajuar trainimin e Romëve/Ciganëve, për të siguruar njohjen e plotë dhe zbatimin e të drejtave të tyre dhe për funksionimin e sistemit ligjor;
- t’u kushtojnë vëmendje të veçantë situatës së Romeve/Ciganeve gra, të cilat shpesh u nënshtrohen diskriminimit të dyfishtë, si gra dhe si Rome/Cigane;
- të luftojnë fuqimisht të gjitha format e veçimit në shkolla të fëmijëve Romë/Ciganë dhe të sigurojnë gëzimin efektiv të aksesit të barabartë në arsim;
- të fusin në programet e të gjitha shkollave informacion për historinë dhe kulturën e Romëve/Ciganëve dhe të ofrojnë programe trainimi në këtë fushë për mësuesit;
- të mbështesin veprimtaritë e organizatave joqeveritare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e racizmit dhe intolerancës kundër Romëve/Ciganëve dhe të cilat u japin atyre në veçanti ndihmë ligjore të përshtatëshme;
- të inkurajojnë organizatat e Romëve/Ciganëve që të luajnë një rol aktiv, me synimin e fuqizimit të shoqërisë civile;
- të zhvillojnë masat për krijimin e besimit që të ruajnë dhe fuqizojnë një shoqëri të hapur dhe pluraliste me synim bashkekzistencën paqësore.

